



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /  
Ministry of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE  
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU  
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në kuadër të Projektit “Instrumenti për Barazi Gjinore”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UN Women - Zyra në Kosovë si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe Mënyrën e Pagesës së Trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, shpall:

## **THIRRJE PËR APLIKIM**

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

### **Integrimi i Perspektivës Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE**

Qëllimi i këtij trajnimi është të pajisë pjesëmarrësit me njohuri, aftësi dhe mjete praktike për të integruar dhe promovuar barazinë gjinore në të gjitha fazat e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Trajnimi synon të krijojë një grup trajnerësh të aftë që do të mund të përcjellin më tej këto njohuri dhe aftësi, në përputhje me kërkesat e integritetit evropian.

Pjesëmarrësit do të forcojnë kapacitetet e tyre për të analizuar, monitoruar dhe avokuar për përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat publike, dokumentet strategjike e ligjore, si dhe reformat sektoriale. Fokusi i veçantë i trajnimit është në kuadrin ligjor, mekanizmat institucional dhe harmonizimin e legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së (acquis) për të siguruar dhe avancuar përfshirjen e barazisë gjinore në këtë proces.

### **Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit**

Trajnimi për Trajnerë (TpT) pritet të mbahet gjatë muajit maj 2025.

### **Vlerësimi i kandidatëve:**

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen gjatë periudhës së trajnimit dhe pas përfundimit të trajnimit.

### **Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:**

- Arsimitimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës (së paku 5 vjet përvojë pune profesionale);
- Përvoja në trajnime;
- Elementet tjera të meritës (publikime në fushën e legjislacionit, pjesëmarrja në hartimin e legjislacionit, certifikatat).

### **Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:**

Aplikantët e suksesshëm do të ndjekin Trajnimin për Trajnerë, prej të cilëve kandidatët që do të certifikohen pas kualifikimit të suksesshëm, të njëjtit do të angazhohen nga IKAP-i si trajner sipas nevojave të programit të trajnimit për Integrimin e Perspektivës Gjimore në Procesin e Anëtarësimit në BE.

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve: **16.04.2025 deri më 30.04.2025.**

Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë biografinë e tyre / **CV** dhe një **letër motivimi** (deri në **400 fjalë**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe.

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në e-mail adresën: [besart.mulaj@rks-gov.net](mailto:besart.mulaj@rks-gov.net) duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

**Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në biografinë / CV tuaj mund të kërkojnë për verifikim nga komisioni vlerësues i IKAP-it.**